

KOMUNA E STRUGËS



**STRATEGJIA PËR  
KULTURË E  
KOMUNËS SË STRUGËS  
2017-2022**

**STRATEGJIA**



**KOMUNA E STRUGËS**



**STRATEGJIA PËR KULTURË E  
KOMUNËS SË STRUGËS  
2017-2022**

nëntor, 2016



## PËRMBAJTJA

<b>1</b>	<b>Rezyme ekzekutive .....</b>	<b>6</b>
<b>2</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>7</b>
<b>3</b>	<b>Vizioni .....</b>	<b>9</b>
<b>4</b>	<b>Parimet dhe vlerat .....</b>	<b>10</b>
<b>5</b>	<b>Politikat vijuese për kulturë në Komunën e Strugës.....</b>	<b>11</b>
<b>6</b>	<b>Harta strategjike.....</b>	<b>13</b>
<b>7</b>	<b>Prioritetet dhe masat strategjike për të rinjtë e Komunës së Strugës deri në vitin 2020 .....</b>	<b>14</b>
7.1	Menaxhimi me buxhetin .....	14
7.2	Zhvillimi i kapaciteteve .....	14
7.3	Sigurimi i shërbimeve .....	15
7.4	Qytetarë të kënaqur .....	15
<b>8</b>	<b>Harta e balancuar e treguesve për fushën e <i>Kulturës</i> të Komunës së Strugës.....</b>	<b>17</b>
<b>9</b>	<b>Monitoring dhe evalvim .....</b>	<b>20</b>

## Lista e shkurtesave

OR	Organizatat e të rinjve
NJVL	Njësia e vetëqeverisjes lokale
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
TKI	Teknologji komunikativo-informative
RM	Republika e Maqedonisë
HBT	Harta e balancuar e treguesve
PEST	Politiko-legjislative, ekonomike, sociale dhe teknologjike (analiza)
SWOT	Analiza e anëve të forta dhe të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet
FSHM	Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni

## Shpjegime terminologjike

Në dokument përdoren terme dhe shprehje, të cilat, varësisht nga përdorimi i tyre i përditshëm në sektorë të ndryshëm të shoqërisë, mund të çojnë te perceptimi i ndryshëm i të njëjtave. Për shkak të kuptimit dhe dallimit të qartë të shprehjeve të përdorura, duhet të merren parasysh këto shpjegime:

1. **Kultura** – "... përmbledhje e veçorive shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie ose grupi shoqëror, në të cilat nuk përfshihen vetëm arti dhe letërsia, por mënyra e jetesës, mënyra e jetesës në bashkësi, sistemet e vlerave, traditat dhe besimet."<sup>1</sup>  
[Kultura] është tërësi komplekse e cila i përfshin dijen, besimet, artin, moralin, zakonet, doket dhe çdo aftësi dhe shprehje tjetër fituar nga ana e [njeriut] si anëtar i shoqërisë.<sup>2</sup>
2. **Arti** – është formë e të shprehurit të vetëdijshëm të kulturës që përfshin elemente kreative, simbolike dhe estetike.
3. **Industritë kulturore** – Industritë kulturore janë ato që kombinojnë krijimin, prodhimtarinë dhe komercializimin e përmbajtjeve kreative të natyrës shpirtërore dhe kulturore. Përmbajtja e tyre zakonisht është e mbrojtur me të drejta të autorit dhe ato mund të jenë në formën e të mirave dhe shërbimeve. Industritë kulturore në përgjithësi përfshijnë shtypjen, publikimin dhe multimedien, produksionet audio-vizuele, fonografike dhe kinematografike, si dhe artizanatet dhe dizajnin.
4. **Industritë kreative** – Industritë kreative përfshijnë spektër më të gjërë të aktiviteteve të cilat i përfshijnë industritë kulturore si dhe të gjitha format dhe proceset e tjera kulturore dhe artistike, pa marrë parasysh se a realizohen drejtëpërdrejtë ose janë të prodhuara si njësi të veçanta. Industritë kreative janë ato, produktet ose shërbimet e të cilave përmbajnë elemente të konsiderueshme të punës artistike ose kreative dhe përfshin aktivitete siç janë arkitektura dhe reklamimi.

<sup>1</sup> UNESCO, 2001

<sup>2</sup> <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/international-migration/glossary/cultural-diversity/>

5. **Organizata** – çdo shoqatë, fondacion, lidhje si dhe çdo formë organizative e organizimit të huaj ose formë tjetër e bashkimit, e regjistruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet;
6. **Grupet e marginalizuara** – në këtë grup futen personat e bashkësive etnike pakicë, personat me nevoja të veçanta dhe personat që janë pjesë e komunitetit LGBT;<sup>3</sup>
7. **Organizata me status të interesit publik** – është organizatë e cila ka fituar statusin e organizatës me interes publik në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet;
8. **Spektori civil/qytetar** – organizatat e regjistruara në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe fondacionet. Strategjia i përdor termet organizata civile/qytetare, shoqëri civile, organizata joqeveritare që referojnë përkufizimin më të ngushtë, si sinonime për shoqatat dhe fondacionet, d.m.th me një fjalë sektori civil/qytetar.
9. **Komuna** – njësi e vetëqeverisjes lokale, si bashkësi e banorëve të rajonit të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila nëpërmjet organeve të saj dhe nëpërmjet administratës dhe shërbimeve të organizuara publike, mundëson kryerjen e kompetencave të parashikuara me ligj.
10. **Partneriteti publiko-privat (PPP)** – Marrëveshje ku sektori privat në mënyrë ortakërie kontribuon financiarisht dhe/ose në mënyrë tjetër drejt përforcimit të objekteve dhe shërbimeve infrastrukturore të cilët tradicionalisht janë siguruar vetëm nga ana e qeverisë.
11. **Teknologjitë komunikativo-informative (TKI)** – përmbledhje teknologjish që merren me përpunimin, ruajtjen dhe komunikimin e informacioneve, përfshirë të gjithë llojet e sistemeve kompjuterike dhe komunikuese.
12. **Harta strategjike** (nga anglishtja Strategic Map) – strukturë logjike e cila shfaq lidhje logjike shkak-pasojë ndërmjet qëllimeve prioritare strategjike.
13. **Harta e balancuar e treguesve HBT** (nga anglishtja Balance Scorecard) është sistem i planifikimit dhe menaxhimit strategjik i cili përdoret në biznes, sektorin publik dhe tek organizatat joprofitabile.

---

<sup>3</sup> Strategjia i trajton të gjithë personat dhe grupet në kontekstin specifik për të cilët përpunohet, e jo si një grup i vetëm.

# 1 REZYME EKZEKUTIVE

Procesi i planifikimit strategjik është dizajnuar që të ndërtojë vizion të përbashkët për të ardhmen, që të vendosen prioritetet, të fokusohen energjia dhe resurset në komunë dhe të sigurohet se këshilltarët, kryetari komunës, të punësuarit dhe palët e tjera të interesuara/prekura që janë pjesëmarrës në proces, punojnë në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Harta strategjike e Komunës së Strugës në fushën e kulturës e tregon rrugën nëpërmjet së cilës komuna mund ta arrijë vizionin e saj mbi zhvillimin, vendin dhe rolin e kulturës në komunë në periudhën prej viti 2017 deri në vitin 2022. Me anë të Hartës së balancuar të treguesve (HBT)<sup>4</sup>, dokumenti i siguron qëllimet prioritare, treguesit kryesorë për arritjen e tyre, vlerat qëllimore të cilat dëshiron t'i arrijë komuna, si dhe masat dhe iniciativat që duhen të sigurojnë realizimin e tyre.

Monitorimi dhe realizimi parimor i masave dhe iniciativave të përfshira në dokument nga ana e kryetarit të komunës, administratës komunale dhe Këshillit të komunës, si dhe mbështetja përkatëse financiare, do të sigurojnë arritjen e vizionit dhe besimit në përkushtim, transparencë dhe efikasitet në Komunën e Strugës në zgjidhjen e problemeve dhe nevojave të të rinjve në komunë.

Procesi gjithëpërfshirës inkluziv i planifikimit strategjik mundësoi që të definohen vizioni dhe prioritetet strategjike në raport me katër perspektivat nga Harta e balancuar e treguesve.

## Vizioni

**STRUGA ËSHTË KOMUNË MULTIKULTURORE, TRASHËGIMI E NJOHUR BOTËRORE E UNESKO-S ME SKENË TË HAPUR TË PASUR, KREATIVITET AKTIV DHE TURIZËM KULTUROR.**

## Prioritetet strategjike

### • Qytetarë të kënaqur

- QK 1. Krijimi i politikës multikulturore dhe përmbajtjeve multikulturore
- QK 2. Njohja e komunës si pjesë e regjionit të Ohrit e mbrojtur nga Unesko-ja
- QK 3. Krijimi i kushteve për manifestimin e diverzitetit kulturor dhe natyror në forma të ndryshme të jetës kulturore

### • Sigurimi i shërbimeve

- SS 1. Rritja e vizitave të lokaliteteve dhe monumenteve lokale kulturore, arkeologjike dhe natyrore
- SS 2. Krijimi i kushteve për manifestimin e të shprehurit kreativ
- SS 3. Vendosja e institucioneve funksionale kulturore lokale

### • Zhvillimi i kapaciteteve

- ZK 1. Vendosja e sistemit efektiv dhe efikas për identifikimin, përcaktimin dhe zbatimin e politikave nga fusha e kulturës

### • Menaxhimi me buxhetin

- MB 1. Rritja e mjeteve buxhetore për realizimin e manifestimeve kulturore
- MB 2. Rritja e mjeteve jobuxhetore për realizimin e manifestimeve kulturore

---

<sup>4</sup> Kaplan, R. and Norton, D., *The Balanced Scorecard, Measures that Drive Performance*, Harvard Business Review (1992)



## 2 HYRJE

Niveli kryesor i organizimit dhe mbështetjes së kulturës është komuna, e cila shpesh kompetencat e saja në fushën e kulturës dhe ngjarjeve kulturore i delegon drejt organizatave që veprojnë në fushën e kulturës, mbështetje për disa shërbime të caktuara ose evenimente kulturore, ndërsa buxhetet e komunave janë burimet kryesore për financimin e evenimenteve nga kultura në nivel lokal, respektivisht të kulturës në përgjithësi. Numri më i madh i problemeve që kanë të bëjnë me kulturën në nivel lokal, janë pasojë e mungesës ose pamundësisë së komunës për mbështetje financiare në implementimin e politikave kulturore; në mungesën dhe mosnxitjen e bashkëpunimit të përbashkët të të gjithë palëve të interesuara/prekura që veprojnë në fushën e kulturës (shoqata civile, institucione, punëtorë të kulturës, artistë etj.) dhe qasja selektive e pushtetit qendror në raport me mbështetjen në zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal.

Komuna e Strugës në tërësi e njeh rëndësinë dhe rolin e kulturës në zhvillimin e komunës, si në zhvillimin dhe përmirësimin e standardit të përgjithshëm të qytetarëve, ashtu edhe të jetës në komunitet si tërësi. Duke u nisur nga këto fakte, Komuna e Strugës nëpërmjet procesit të planifikimit strategjik vendosi t'i mobilizojë të gjithë palët e interesuara rreth çështjes së kulturës dhe t'i stimulojë të gjitha palët e interesuara në komunë që veprojnë ose janë të lidhur me fushën e kulturës të avancojnë bashkëpunimin e tyre. *Strategjia për kulturë e Komunës së Strugës 2017-2022 është rezultat i atij përkushtimi dhe e njëjta bazohet në bashkëpunimin e komunës me të gjitha palët e interesuara për politikën lokale për kulturën dhe ka për qëllim të sigurojë proces inkluziv dhe interaktiv në proceset e përcaktimit të aktiviteteve dhe iniciativave zhvillimore të Komunës së Strugës në fushën e kulturës me përfshirjen e sektorit civil, institucioneve, punonjësve të kulturës dhe individëve si dhe të krijojë parakushte për krijimin e partneriteteve efikase dhe stabile. Strategjia bashkë me planin aksionar është përgatitur në mënyrë konsultative dhe pjesëmarrëse, gjatë periudhës maj-nëntor të vitit 2016<sup>5</sup>.*

Krijimi i parakushteve cilësore, përkushtimi i strukturave më të larta udhëheqëse dhe motivimi i palëve të interesuara për pjesëmarrje në proces janë faktorët kryesorë për një planifikim të suksesshëm strategjik. Në këtë drejtim ishte siguruar një qasje dhe përkushtim gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrje aktive e anëtarëve të kështillit, administratës komunale, institucioneve, shoqatave civile, punonjësve të kulturës dhe individëve në procesin e krijimit të strategjisë. Në fakt, procesi i krijimit të strategjisë paraprakisht ishte mbështetur me seri trajnimesh për: përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale dhe organizatave – për krijimin participativ të politikave dhe planifikimit strategjik duke shfrytëzuar Hartën e balancuar të treguesve. Procesit të planifikimit strategjik i parapriu përgatitja e analizës gjithëpërfshirëse të gjendjes momentale në komunë, e cila u realizua duke analizuar dokumentet relevante ekzistuese si dhe nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave me të gjitha palët e interesuara, si nga administrata komunale ashtu edhe me përfaqësuesit e organizatave që veprojnë në fushën e kulturës<sup>6</sup>. Në procesin e përgatitjes së Strategjisë u morën parasysh të gjitha dokumentet strategjike ekzistuese mbi politikën për kulturë në nivel lokal, rajonal dhe nacional. Procesi vazhdoi me organizimin e tri punëtorive për përgatitjen e strategjisë dhe planit aksionar, me qëllim që të sigurohet debat i hapur dhe përshtatje të politikave dhe prioritetëve dhe masave të propozuara

---

<sup>5</sup>Përgatitja e Strategjisë është mbështetur në kuadër të projektit Pjesëmarrja civile për demokraci lokale financuar nga **Komisioni Evropian** në kuadër të **IPA Civil Society Facility and Media Programme 2014**, ndërsa zbatohet nga **Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni (FSHM)** në bashkëpunim me **Qendrën për Zhvillim të Demokracisë Lokale (QZDL)** në periudhën 2016 – 2017.

<sup>6</sup> Raporti për gjendjen momentale në fushën e kulturës në Komunën e Strugës, maj 2016

strategjike, si dhe të rritet ndjenja e pronësisë në raport me strategjinë e përgatitur dhe të rritet fokusimi dhe përgjegjësia në procesin e implementimit të saj. Planifikimi strategjik u bazua në përdorimin e modelit të Hartës së balancuar të treguesve dhe përbëhej prej:

- analizës dhe hulumtimit gjithëpërfshirës të gjendjes momentale në komunë në fushën e kulturës (dy faza);
- analizës së palëve të interesuara;
- trajnimeve të palëve të interesuara (3 trajnimet e lartpërmendura);
- përgatitjes së analizës PEST;
- përgatitjes së analizave SWOT dhe TOWS;
- formulimit të vizionit dhe misionit;
- identifikimit dhe përcaktimit të parimeve dhe vlerave;
- përcaktimit dhe përzgjedhjes së qartë të qëllimeve prioritare strategjike;
- përgatitjes së Hartës strategjike;
- përcaktimit të treguesve kryesorë të paraqitjes;
- përcaktimit të vlerave fillestare dhe qëllimore të çdo treguesi kryesor (përfshirë treguesin e pasqyrimin në fund të planit të parë aksionar);
- identifikimit të masave dhe aktiviteteve për arritjen e vlerave qëllimore;
- përgatitjen e Hartës së balancuar të treguesve;
- shqyrtimit të materialeve dhe dokumenteve të përgatitura me palët e interesuara (pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të njëjtëve);
- përgatitjes së propozim-versionit të Strategjisë;
- dëgjesës publike;
- Propozim-versionit të Strategjisë dhe Planit aksionar.

Strategjia është përgatitur mbi bazën e Raportit për gjendjen momentale në fushën e kulturës në Komunën e Strugës dhe analizës strategjike të gjendjes dhe është përcjellë me plan aksionar, në të cilin janë vendosur aktivitete dhe projekte konkrete që do të kontribuojnë për përmbushjen e prioriteteve dhe masave të përcaktuara strategjike në drejtim të përmbushjes së vizionit të komunës.

Dokumenti është në përputhje me:

- Strategjinë nacionale për kulturë të Republikës së Maqedonisë (Ministria e Kulturës) viti 2013 – 2017;
- Programin për zhvillim të Rajonit planor jugperëndimor 2015 – 2019;
- Strategjinë për të rinj të Komunës së Strugës për periudhën 2015 – 2020; dhe
- Strategjinë për bashkëpunim me sektorin civil të Komunës së Strugës për periudhën 2015 – 2020.

### 3 VIZIONI

STRUGA ËSHTË KOMUNË MULTIETNIKE, TRASHËGIMI E NJOHUR E UNESKO-s ME SKENË TË HAPUR TË PASUR, KREATIVITET AKTIV DHE TURIZËM KULTUROR.

*Ky vizion i Komunës së Strugës do të arrihet me respektimin parimor të parimeve dhe vlerave të përcaktuara në partneritet me organizatat që veprojnë në fushën e kulturës, nëpërmjet: rritjes së mëtutjeshme të shumave të mjeteve financiare nga burimet buxhetore dhe jobuxhetore, të dedikuara për programet e kulturës në komunë; vendosjen e sistemit efikas dhe efektiv të identifikimit, përcaktimit dhe zbatimit të politikave nga fusha e kulturës; vendosjen e institucioneve funksionale kulturore lokale; krijimin e kushteve për manifestimin e të shprehurit kreativ; krijimin e politikave multikulturore dhe përmbajtjeve multikulturore; dhe njohjen e valorizuar të komunës si pjesë e rajonit të Ohrit, e mbrojtur nga UNESKO-ja.*

## 4 PARIMET DHE VLERAT

Gjatë procesit të realizimit të prioriteteve dhe masave strategjike për arritjen e vizionit të Komunës së Strugës për zhvillimin e kulturës për periudhën 2017-2022, do të mbështetemi në këto parime dhe vlera:

- **TRANSPARENCA** – do të promovohet nivel sa më i lartë i transparencës së informacioneve me të cilët disponohet, shërbimet që ofrohen, procedurat sipas së cilave realizohen, kriteret në bazë të cilave sigurohen dhe shpenzimet e kostos së realizimit të tyre. Komuna do të sigurojë shikueshmëri në drejtim të njohjes së problemeve dhe nevojave prioritare në fushën e kulturës nga ana e palëve të interesuara dhe bashkësisë lokale si shfrytëzues i fundit.
- **QASJA E HAPUR** – Në Komunën e Strugës stimulohen të gjitha format e bashkëpunimit pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore, seksuale apo atë të gjeneratës. Hapja e horizonteve të reja nëpërmjet krijimit të mundësive për të shprehurit e të gjitha formave të veprimit kualitativ.
- **KREATIVITETI** – Gjetja e metodave dhe formave kreative dhe inovative për kryerjen e pandërprerë të politikave dhe evenimenteve kulturore dhe zhvillim të vazhdueshëm të tyre me qëllim përmbushjen e nevojave të komunitetit lokal.
- **BARAZIA** – Komuna e Strugës do të mundësojë qasje dhe shanse të barabarta për të gjitha palët e interesuara (direkte dhe indirekte), të drejtën e qasjes tek informacionet, zhvillimin institucional, organizativ dhe individual, qasjen te mjetet dhe shërbimet e disponueshme financiare, por duke respektuar barazinë gjinore, jodiskriminimin, lirinë, dinjitetin dhe sigurinë e të gjithë palëve të interesuara dhe shfrytëzuesve të fundit.
- **MULTIKULTURALIZMI** – Komuna e Strugës do të mundësojë respektimin e dallimeve në të gjitha fushat e jetës njerëzore, tolerancës, si dhe afirmimin e qasjeve artistike dhe kreative drejtuar kah ruajtja dhe zhvillimi i dialogut ndërkulturor ndërmjet të rinjve.
- **PËRKUSHTIMI** drejt përforcimit të kapaciteteve të administratës komunale, punonjësve të kulturës, përfaqësuesve të qytetarëve dhe organizatave civile si resursi më i rëndësishëm shoqëror, me qëllim, punë dhe realizim efektiv dhe efikas të aktiviteteve në kuadër të përcaktimeve strategjike, programeve të parashikuara komunale, transparencës dhe inkluzivitetit në krijimin e programeve, projekteve, masave dhe aktiviteteve të ardhshme në fushën e kulturës.

## 5 POLITIKAT VIJUESE PËR KULTURË NË KOMUNËN E STRUGËS

Sipas analizës strategjike, në Komunën e Strugës gjatë periudhës së kaluar nuk janë regjistruar përpjekje për krijimin e politikave lokale për kulturë dhe për momentin Komuna nuk ka dokumente valide strategjike në fushën e kulturës. Zhvillimin e saj strategjik në fushën e kulturës, Komuna e bazon dhe realizon në bazë të programeve vjetore për kulturë të cilët i miraton Këshilli i Komunës, me propozim të Komisionit për shënimin e festave dhe manifestimeve, dhënien e shpërblimeve dhe mirënjohjeve. Në situatë kur nuk janë përgatitur politika dhe dokumente strategjike që kanë të bëjnë vetëm për kulturën, zhvillimi i kësaj fushe bazohet në politikat afatshkurtra të Këshillit të Komunës dhe të Kryetarit të Komunës ose në aktivitetet për të cilat ekziston mundësia për realizim në përputhje me mundësitë ekzistuese financiare të Komunës ose burimeve të tjera të financimit (buxheti qendror, donatorë, hua, partneritete publiko-private etj).

Në strukturën organizative të Komunës, jeta kulturore është nën kompetencat e Sektorit për arsim, kulturë dhe sport – Njësia për kulturë, sport dhe të rinj. Sipas Sistematizimit të vendeve të punës në Komunë, nga pesë pozita pune në Njësinë për kulturë, sport dhe të rinj, vetëm dy pozita kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me kulturën: „Bashkëpunëtor për kulturë“ dhe „Regjistruar i projekteve në kulturë“

Për momentin, projektet që kanë të bëjnë me kulturën në Komunën e Strugës janë pjesë e aktiviteteve të Programit vjetor për kulturë (Programi K4) në bazë të së cilit realizohet financimi i aktiviteteve lidhur me kulturën. Nëpërmjet programit për kulturë, komuna në masën më të madhe mbështet manifestime dhe evenimente tradicionale që mbahen në territorin e saj (Netët strugane të poezisë, Festivali „Këngë Jeho“, manifestimet njëjavore kulturore të shqiptarëve, maqedonasve, turqve, romëve dhe vllahve, si dhe rreth pesëmbëdhjetë manifestime të rregullta të llojeve të ndryshme artistike dhe nga kultura popullore). Pjesë e mjeteve të parashikuara me Programin vjetor për kulturë janë dedikuar për mbulimin e shpenzimeve teknike për mbajtjen e manifestimeve kulturore, për akomodimin e pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore dhe për mbështetjen e shoqërive kulturore-artistike.

Mjetet që ndahen nga Buxheti i komunës për mbështetjen e aktiviteteve në fushën e kulturës janë të pakonsiderueshme. Pjesa më e madhe e aktiviteteve lidhur me kulturën janë financuar nëpërmjet transfertës së mjeteve tek organizatat që punojnë në fushën e kulturës. Në numrin më të madh të rasteve, buxheti i Komunës së Strugës vetëm është prezantuar në dëgjuesat publike dhe organizatat nuk janë përfshirë në krijimin e tij.

Nga kabineti i Kryetarit të Komunës, komuna praktikon politikën e „derës së hapur“ për shoqatat civile dhe organizatorët e tjerë të evenimenteve nga fusha e kulturës, për mbështetjen e mbajtjes së evenimenteve dhe manifestimeve nga fusha e kulturës.

Institucionet nga fusha e kulturës në territorin e komunës janë me status të enteve shtetërore dhe komuna nuk ka vendosur mekanizëm nëpërmjet të cilit do mund të ndikonte mbi punën e tyre.

Për informimin e publikut më të gjerë për eventet dhe manifestimet nga kultura, Komuna dërgon lajmërimi dhe ftesa për përcjelljen e evenimenteve deri te mediumet lokale dhe nacionale, ndërsa informacionet mbi punën e Komunës nga fusha e kulturës, publikohen në ueb-faqen e Komunës.

Mbledhjet e Këshillit janë publike dhe të hapura për të gjithë të interesuarit. Rendi i ditës për çdo mbledhje rregullisht publikohet në ueb-faqen e komunës, kurse të gjithë qytetarët ose organizatat e interesuara me kërkesë të tyre mund ti marrin materialet nga mbledhjet.

Rajoni Jugperëndimor, në përgjithësi, e në kuadër të tij edhe Komuna e Strugës, sipas shumë treguesve (BPSH për kokë banor, punësime, investime në mjete themelore etj.) është njëri ndër më të varfrit në Republikën e Maqedonisë. Komuna e Strugës ka saldo negative të migracionit. Liberalizimi i

regjimit të vizave, varfëria dhe mundësitë sa më të mëdha të të rinjve për të mësuar, studiuar ose punuar jashtë vendit, mundësojnë rritjen e trendit të shpërnguljes të popullsisë së re dhe të aftë për punë nga komuna.


Komuna është bashkësi multikulturore dhe multietnike me traditë të bashkëjetesës dhe ndihmës së bashkëqytetarëve. Rritja e përjashtimit etnik dhe intolerancës ndëretnike në RM paraqet kërcënim për zhvillimin e Komunës së Strugës, përfshirë edhe zhvillimin e kulturës.

## 6 HARTA STRATEGJIKE

Harta strategjike ofron fotografi të plotë të ndërlidhjes shkak-pasojë të prioriteteve të Komunës së Strugës në arritjen e Vizionit për zhvillimin e kulturës deri në vitin 2022, nëpërmjet katër perspektivave:

- Qytetarë të kënaqur;
- Sigurimi i shërbimeve;
- Zhvillimi i kapaciteteve, dhe
- Menaxhimi me buxhetin.

Në bazë të analizave gjithëpërfshirëse të secilës prej perspektivave janë definuar qëllimet prioritare strategjike (strategjike) për çdo perspektivë në veçanti.



## 7 PRIORITETET DHE MASAT STRATEGJIKE PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË STRUGËS DERI NË VITIN 2020

### 7.1 *Menaxhimi me buxhetin*

Në raport me perspektivën financiare, anët e forta të Komunës së Strugës janë përvojat e deritanishme nga mbështetja e rregullt financiare e cila ndahet nga buxheti i komunës për organizatat që veprojnë në fushën e kulturës, përvojat e administratës komunale dhe organizatave që veprojnë në fushën e kulturës të aplikojnë dhe zbatojnë projekte të financuara nga organizatat ndërkombëtare. Por, edhe përkaj praktikës shumëvjeçare për financimin e organizatave që veprojnë në fushën e kulturës, pjesa e buxhetit që shfrytëzohet për këtë qëllim është shumë e vogël dhe e pamjaftueshme, që është njëra ndër anët e dobëta të kësaj perspektive. Përveç kësaj, si anë të dobëta të rëndësishme janë identifikuar edhe: niveli i pamjaftueshëm i pjesëmarrjes së organizatave që veprojnë në fushën e kulturës gjatë planifikimit të programeve dhe buxhetit, mosekzistimi i procedurave publike për garantimin e mjeteve, mosinteresimi i sektorit të biznesit për mbështetje më të madhe të kulturës në komunë, si dhe bashkëpunimi i dobët ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal.

Rritja e buxhetit për nevojat e kulturës dhe qasja deri te Fondet e BE-së janë identifikuar si mundësi më të rëndësishme, kurse mosmbështetja nga pushteti qendror, mospajtimi ndërmjet partive politike në nivel lokal dhe jolikuiditeti i komunës janë kërcënimet kryesore në këtë perspektivë.

Për këto arsye, duhet të zgjidhen strategji për përmirësim të cilët do t'i shfrytëzojnë përparësitë e mundësive nëpërmjet tejkalimit të anëve të dobëta dhe strategji për shmangie të cilët do t'i minimizojnë anët e dobëta dhe do t'i tejkalojnë kërcënimet. Në masë të caktuar, mund të merren parasysh edhe strategjitë ofensive të cilët do t'i shfrytëzojnë anët e forta që t'i shfrytëzojnë përparësitë e mundësive.

Qëllimet prioritare strategjike që dolën nga analiza strategjike e perspektivës *Menaxhimi me buxhetin* janë dy strategji ofensive (MB 1 dhe MB 2):

- MB 1. Rritja e mjeteve buxhetore për realizimin e manifestimeve kulturore
- MB 2. Rritja e mjeteve jobuxhetore për realizimin e manifestimeve kulturore

Për arritjen e këtyre prioritetëve janë të nevojshme masa për: proces transparent për krijimin e programit vjetor për kulturë – përfshirjen e organizatave që veprojnë në fushën e kulturës në procesin e planifikimit të buxhetit; masa për rritjen e kapacitetit për shfrytëzimin e mjeteve shtetërore dhe ndërkombëtare; si dhe masa për vendosjen e dialogut publiko privat në fushën e kulturës.

### 7.2 *Zhvillimi i kapaciteteve*

Anët e forta të Komunës së Strugës nga aspekti i perspektivës *Zhvillimi i kapaciteteve* janë administrata e re multietnike dhe dygjuhësore, numri i madh i personave të rinj dhe artistëve të rinj të talentuar, si dhe hapja për bashkëpunim me organizatat nga fusha e kulturës. Megjithatë, koordinimi i pamjaftueshëm, joekipimi i mjaftueshëm i administratës komunale, politika jopërkatëse kadrovike dhe mungesa e dijeve dhe shkathtësive për krijimin dhe zbatimin e politikave lokale për kulturë janë anët më të rëndësishme të dobëta në këtë perspektivë.



Për realizimin e ndryshimeve dhe përshtatjen e proceseve të brendshme organizative për sigurimin e shërbimeve më cilësore, është i domosdoshëm krijimi i klimës më të volitshme organizative për të mësuar dhe për zhvillim, d.m.th. për zhvillimin e kapaciteteve. Krijimi i organizimit lokal i cili do t'i bashkojë të gjithë përpjekjet për zhvillimin e kulturës në komunë, për shfrytëzimin e fondeve të BE-së, pjesëmarrjen në projektet vijuese dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja janë mundësi për rritjen e kapaciteteve të individëve dhe organizatave të përfshira në procesin e zhvillimit të kulturës në Komunën e Strugës. Si kërcënime janë identifikuar trendet negative demografike dhe partizimi i ndjekur me nepotizëm dhe korrupsion.

Në këtë perspektivë mbizotërojnë dobësitë, por ato ndiqen me anët e forta të identifikuara. Analiza na tregon se duhet të zhvillohen strategji të cilët do të minimizojnë anët e dobëta dhe strategji të cilat do t'i shfrytëzojnë anët e forta për të shfrytëzuar përparësitë e mundësive.

Prioritetet strategjike që dolën nga analiza strategjike e perspektivës *Zhvillimi i kapaciteteve* është një strategji për përmirësim: (ZK 1)

- ZK 1. Vendosja e sistemit efikas dhe efektiv për identifikimin, përcaktimin dhe zbatimin e politikave nga fusha e kulturës.

Për arritjen e këtyre prioritetëve janë të nevojshme masa për: sigurimin e kushteve për formimin e marrëdhënieve të ortakërisë të komunës me organizatat nga komuna për pjesëmarrje të përbashkët në projekte nga fusha e kulturës; krijimin e klasterit lokal komunal për kulturë; dhe sigurimin e kushteve për bashkëpunim, rrjetëzim dhe përforsim të kapacitetit të shoqërive kulturoro-artistike të etnive dhe sferave të ndryshme.

### 7.3 Sigurimi i shërbimeve

Gjatë analizës së kësaj perspektive janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i anëve të dobëta, por edhe numër të konsiderueshëm të mundësive. Numri i tyre në raport me anët e forta dhe kërcënimet është disa herë më i madh, që na çon te përfundimi se duhet të zhvillohen strategji të cilët do t'i shfrytëzojnë përparësitë e mundësive nëpërmjet tejkalimit të anëve të dobëta.

Prioritetet strategjike që dolën nga analiza strategjike e perspektivës Sigurimi i shërbimeve janë tri strategji për përmirësim (SS 1, SS 2 dhe SS 3):

- SS 1. Rritja e vizitave të lokaliteteve dhe monumenteve lokale kulturore, arkeologjike dhe natyrore
- SS 2. Krijimi i kushteve për manifestimin e të shprehurit kreativ
- SS 3. Vendosja e institucioneve funksionale lokale kulturore

Për arritjen e këtyre prioritetëve janë të nevojshme masa për: krijimin e strategjisë së marketingut për kulturë; përmirësimin e infrastrukturës turistike; masave për brandimin e produkteve kulturore; krijimin e punëtorive dhe klubeve kreative; vendosjen e qendrës funksionale kulturore për të rinj; masave për vendosjen e institucioneve lokale kulturore dhe sigurimin e kushteve për krijimtari kreative.

### 7.4 Qytetarë të kënaqur

Shikuar nga aspekti i zhvillimit të kulturës, anë e fortë e Komunës së Strugës është fakti se Struga është komunë multikulturore me traditë të pasur, qytet turistik me vendndodhje të mirë, komunë e cila në pjesën e saj më të madhe është e mbrojtur nga UNESCO-ja, si pjesë e rajonit të Ohrit i cili

është njëri ndër 39 trashëgimitë e përziera në botë i mbrojtur nga UNESCO-ja, komunë me diverzitet të pasur kulturor.

Duke marrë parasysh numrin e madh të anëve dhe mundësive të forta të identifikuara, duhet të zhvillohen strategji të cilat do t'i shfrytëzojnë anët e forta për shfrytëzimin e mundësive, si dhe strategji të cilët do t'i zhvillojnë anët e dobëta që të shfrytëzohen mundësitë.

Prioritetet strategjike që dolën nga analiza strategjike e perspektivës Qytetarë të kënaqur janë tre strategji të ndryshme, dy strategji ofensive (QK 1 dhe QK 2) dhe një strategji për përmirësim (QK 3):

- QK 1. Krijimi i politikave multikulturore dhe përmbajtjeve multikulturore
- QK 2. Njohja e komunës si pjesë e regjionit të Ohrit e mbrojtur nga UNESCO-ja
- QK 3. Krijimi i kushteve për manifestimin e diverzitetit kulturor dhe natyror në forma të ndryshme të jetës kulturore.

Për arritjen e këtyre prioritetëve janë të nevojshme masa për: sigurimin e kushteve dhe mekanizmave për mbështetje dhe promovim të evenimenteve multikulturore; organizimin e promociioneve të rajonit të Strugës si pjesë e rajonit më të gjerë të Ohrit, i mbrojtur nga UNESCO-ja; edukimin e palëve dhe rrjetëzimin e tyre; krijimin e mekanizmave për mbështetje të të shprehurit kreativ dhe jetës kulturore; dhe përfshirjen interaktive të vizitorëve në përgatitjen dhe realizimin e evenimenteve.

## 8 HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE PËR FUSHËN *KULTURËE* KOMUNËS SË STRUGËS

Harta e balancuar e treguesve mundëson që të monitorohet më mirë se cilët hapa strategjikë do t'i ndërmarrë Komuna e Strugës për zhvillimin e kulturës në periudhën prej vitit 2017-2022 dhe cilat rezultate duhet t'i arrijë që ta realizojë vizionin e saj për zhvillimin e kulturës në komunë.

Me qëllim që të sigurohet fokus dhe prioritizim më i mirë strategjik në zbatimin e aktiviteteve, si bazë e progresit është dhënë vlera fillestare, respektivisht viti 2016. Variabla, respektivisht vlera e indikatorit të treguesit është ndarë në ato që duhen të realizohen në vitin 2019 (me Planin e parë aksionar) dhe vlerat qëllimore të indikatorëve që duhen të realizohen në fund të zbatimit të strategjisë deri në vitin 2022.

Harta e balancuar e treguesve është dhënë si më poshtë.

**HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR FUSHËN E KULTURËS  
2017-2022**

**VIZIONI:**

**STRUGA ËSHTË KOMUNË MULTIKULTURORE, TRASHËGIMI E NJOHUR BOTËRORE E UNESKO-s ME SKENË TË PASUR TË HAPUR, KREATIVITET AKTIV DHE TURIZËM KULTUROR**

<i>Prioritetet</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Vlera fillestare</i>	<i>Vlera qëllimore</i>		<i>Masa/Iniciativa</i>
		<i>2016</i>	<i>2019</i>	<i>2022</i>	
<b>QYTETARË TË KËNAQUR</b>					
QK1. KRIJIMI I POLITIKËS MULTIKULTURORE DHE PËRMBAJTJEVE MULTIKULTURORE	1.1 NUMRI I EVENIMENTEVE TË ORGANIZUARA	20 evenimente në vit	min. 30 eveniment e në vit	min. 40 evenimente në vit	1. SIGURIMI I KUSHTEVE DHE MEKANIZMAVE PËR MBËSHTETJE DHE PROMOVIM TË EVENIMENTEVE MULTIKULTURORE
QK2. NJOHJA E KOMUNËS SI PJESË E RAJONIT TË OHRIT E MBROJTUR NGA UNESKO-ja	2.1 NUMRI I PËRMENDJEVE TË STRUGËS SI PJESË E REGJIONIT TË UNESKO	0 përmendje në vit	min. 30 përmendje e në vit	min. 20 përmendje në vit	1. PROMOCIONE TË ORGANIZUARA TË RAJONIT TË STRUGËS SI PJESË E UNESKO-s
					2. EDUKIMI I PALËVE DHE RRJETËZIMI I TYRE
QK3. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR MANIFESTIMIN E DIVERZITETIT KULTUROR DHE NATYROR NË FORMA TË NDRYSHME TË JETËS KULTURORE	3.1 SHKALLA E KËNAQËSISË SË VIZITORËVE	nuk ka të dhëna	40% të vizitorëve i kanë vlerësuar evenimentet	70% të vizitorëve i kanë vlerësuar evenimentet	1. KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR MBËSHTETJE TË TË SHPREHURIT KREATIV DHE JETËS KULTURORE
	3.2 NUMRI I FORMAVE TË NDRYSHME TË KRIJUARA TË RËNDËSISHME PËR JETËN KULTURORE	nuk ka të dhëna	2 forma të reja në vit	5 forma të reja në vit	2. PËRFSHIRJA INTERAKTIVE E VIZITORËVE NË PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E EVENIMENTEVE
<b>SIGURIMI I SHËRBIMEVE</b>					
SS1. RRRITJA E VIZITAVE TË LOKALITETEVE DHE MONUMENTEVE LOKALE KULTURORE, ARQELOGJIKE DHE NATYRORE	1.1 NUMRI I PËRMBAJTJEVE TË GJENERUARA	0	>20 në vit	>36 në vit	1. KRIJIMI I STRATEGJISË SË MARKETINGUT PËR KULTURË
	1.2 NUMËR I RRRITUR I VIZITORËVE NË NIVEL VJETOR	0	+10%	?	2. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS TURISTIKE
SS2. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR MANIFESTIMIN E TË SHPREHURIT KREATIV	2.1 NUMRI I EVENIMENTEVE KREATIVE TË REJA/TË NDRYSHME	0	4	10 nga 2 në vit	1. MASA PËR BRANDIMIN E PRODUKTEVE KULTURORE
					2. KRIJIMI I PUNËTORIVE DHE KLUBEVE KREATIVE

SS3. VENDOSJA E INSTITUCIONEVE FUNKSIONALE LOKALE KULTURORE	3.1 NUMRI I INSTITUCIONEVE FUNKSIONALE LOKALE	0	2 institucione	5 institucione	1. VENDOSJA E QENDRËS FUNKSIONALE KULTURORE PËR TË RINJ
					2. MASA PËR VENDOSJEN E INSTITUCIONEVE LOKALE KULTURORE
					3. SIGURIMI I KUSHTEVE PËR KRIJIMTARI KREATIVE
<b>ZHVILLIMI I KAPACITETEVE</b>					
ZK1. VENDOSJA E SISTEMIT EFEKTIV DHE EFIKAS PËR IDENTIFIKIMIN, PËRCAKTIMIN DHE ZBATIMIN E POLITIKAVE NGA FUSHA E KULTURËS	1.1 NUMRI I PROJEKTEVE TË REALIZUARA TË PËRBASHKËTA NDËRMJET KOMUNËS DHE OJQ-ve	0	7	15	1. SIGURIMI I KUSHTEVE PËR FORMIMIN E MARËDHËNIEVE TË ORTAKËRISË SË KOMUNËS ME SHC PËR PJESËMARRJE TË PËRBASHKËT NË PROJEKTE NGA FUSHA E KULTURËS
	1.2 VLERA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA	0	18 mil. MKD	1.000.000	2. KRIJIMI I KLASTERIT LOKAL KOMUNAL PËR KULTURË
	1.3 NUMRI I SHKA-ve AKTIVE TË ETNIVE TË NDRYSHME	6	7	8	3. SIGURIMI I KUSHTEVE PËR BASHKËPUNIM, RRJETËZIM DHE PËRFORCIM TË KAPACITETIT TË SHOQËRIVE KULTURORO-ARTISTIKE TË ETNIVE DHE SFERAVE TË NDRYSHME
<b>MENAXHIMI ME BUXHETIN</b>					
MB1. RITJIA E MJETEVE BUXHETORE PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMEVE KULTURORE	1.1 % TË BUXHETIT QË NDAHET PËR EVENIMENTE KULTURORE	1%		2%	1. PROCES TRANSPARENT PËR KRIJIMIN E PROGRAMIT VJETOR PËR KULTURË
	1.2 LARTËSIA E SHUMËS TË BUXHETIT DEDIKUAR PËR EVENIMENTE KULTURORE	4,5 mil. MKD	6 mil. MKD	8 mil. MKD	2. RITJIA E TRANSPARENCËS NË PROCESIN E BUXHETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË MJETEVE BUXHETORE
MB2. RITJIA E MJETEVE JOBUXHETORE PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMEVE KULTURORE	2.1 SHUMA E MJETEVE NGA BUXHETI QËNDROR	TDI	TDO	TDO	1. RITJIA E KAPACITETIT PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE SHTETËRORE DHE NDËRKOMBËTARE
	2.2 SHUMA E MJETEVE NGA FONDET NDËRKOMBËTARE	7,2 mil. MKD	20 mil. MKD	54 mil. MKD	
	2.3 SHUMA E MJETEVE NGA PPP	0	TDI	TDI	2. MASA PËR VENDOSJEN E DIALOGUT PRIVATO PUBLIK NË FUSHËN E KULTURËS
	2.4 SHUMA E MJETEVE NGA INICIATIVAT PRIVATE	TDI	TDO	TDO	
<b>VLERAT: TRANSPARENCË, QASJE E HAPUR, KREATIVITET, BARAZI, MULTIKULTURALIZËM, PËRKUSHTIM</b>					

## 9 MONITORIMI DHE EVALVIMI

Harta e balancuar e treguesve paraqet vegël të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për kulturë të Komunës së Strugës 2017-2022, duke marrë parasysh faktin se të gjitha qëllimet dhe masat – financiare dhe jofinanciare – rezultojnë nga vizioni. Arritja e përfitimeve nga HBT-ja e komunës monitorohet nëpërmjet raporteve, diskutimeve, komunikimit, azhurnimit dhe veprimit. Raportet e HBT të komunës përgatiten në afat tremujor sipas radhitjes së përcaktuar. Ndër të tjera, në procesin e monitorimit rol të tyre kanë edhe kryetari i komunës, sekretari dhe udhëheqësit e sektorëve përgjegjës për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për qëllimet përkatëse prioritare strategjike.

Roli i kryetarit të komunës është të emërojë person përgjegjës për zbatimin e Strategjisë për kulturë të Komunës së Strugës 2017-2022. Personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë i kryen këto aktivitete:

- e koordinon grumbullimin e informacioneve nga sektorët;
- i njofton udhëheqësit e sektorëve për afatet e fundit për dorëzimin e raporteve sektoriale;
- i konsolidon raportet sektoriale në një Raport të vetëm për HBT të Komunës së Strugës për kulturë;
- e dorëzon raportin e konsoliduar te sekretari, kryetari i komunës dhe te këshilltarët e Komunës së Strugës; dhe
- e ndjek dhe e zbaton procesin e futjes së ndryshimeve në HBT.

Roli i udhëheqësve të sektorëve në procesin e monitorimit të arritjes së vlerave qëllimore të HBT-së të Komunës së Strugës për kulturë përbëhet nga:

- përcaktimi i personit përgjegjës për çdo tregues të prioriteteve strategjike të cilët janë pjesë e qëllimeve sektoriale;
- përgatitja e raportit mbi zbatimin e aktiviteteve në nivel të sektorit, dhe
- pjesëmarrja në revidimin e treguesve për çdo qëllim prioritar që është pjesë e qëllimeve sektoriale.

Personi përgjegjës për çdo tregues të qëllimeve prioritare strategjike në procesin e monitorimit të arritjes së vlerave qëllimore të HBT i kryen këto aktivitete:

- e koordinon grumbullimin e informacioneve në kuadër të sektorit;
- e njofton udhëheqësin e sektorit mbi afatet e fundit për dorëzimin e raportit sektorial;
- përgatit raport të vetëm sektorial dhe ia dorëzon udhëheqësit të sektorit;
- e monitoron dhe e zbaton procesin e futjes së ndryshimeve në HBT.

Përveç për monitorim, HBT do të shfrytëzohet edhe për evalvimin e zbatimit të planit strategjik, me qëllim që të përcaktohet se a janë arritur qëllimet e planifikuara të politikave në mënyre efikase dhe se në çfarë shkalle janë paraqitur efektet e padëshiruara. Pengimi ose ndërprerja e ndërlidhjes shkak-pasojë e prioriteteve, si dhe mospërmbushja e vlerave qëllimore të treguesve për prioritete të caktuara do të japë informacion për atë se a duhet të bëhen ndryshime dhe çfarë ndryshimesh duhet të bëhen në planin strategjik.

Komuna do të përgatitë plan të veçantë për menaxhimin me Kulturën në nivel lokal, si dokument operativ i komunës, i cili do t'i përcaktojë për së afërmi raportet dhe proceset, ndërmjet të gjitha palëve të interesuara dhe aktorëve të përfshirë në procesin e zbatimit të Strategjisë për kulturë të Komunës së Strugës.

**PLANI AKSIONAR**  
**PËR**  
**STRATEGJINË LOKALE PËR**  
**KULTURË I KOMUNËS SË STRUGËS**  
**PËR PERIUDHËN NGA VITI 2017 DERI NË VITIN 2019**

nëntor, 2016

## **PËRMBAJTJA**

HYRJE .....	3
HARTA STRATEGJIKE .....	4
QËLLIMET E PLANIT AKSIONAR.....	5
AKTIVITETE NË PLANIN AKSIONAR .....	7
PLANI AKSIONAR PËR PERIUDHËN 2017-2019 .....	8
BURIMET E FINANCIMIT TË PLANIT AKSIONAR .....	25
MONITORIMI DHE EVALUIMI .....	26



## HYRJE

Nevoja e Komunës së Strugës për dokument strategjik në kulturë doli që nga koha e realizimit të projektit “Komunë sipas masës së qytetarëve“ dhe përgatitjes së strategjive për të rinjtë, bashkëpunimit të komunës me sektorin civil, politikën sociale dhe arsimin.

Përcaktimet kryesore strategjike të nevojave të tanishme dhe të ardhme të Komunës së Strugës në kulturë janë përcaktuar në *“Strategjinë për kulturë të Komunës së Strugës 2017 – 2022“*. Strategjia përmban vizion të përcaktuar, parimet kryesore për zbatimin e saj, si dhe prioritetet strategjike, masat, iniciativat dhe aktivitetet për realizimin e vizionit të paramenduar.

Vizioni i përcaktuar, parimet kryesore për zbatimin e saj, si dhe prioritetet strategjike dhe masat janë përfshirë në Hartën strategjike për kulturë të Komunës së Strugës. E njëjta paraqet pasqyrë të lidhjes shkak-pasojë në realizimin e vizionit të komunës në fushën e kulturës e cila duhet të plotësohet me përfshirjen e drejtpërdrejtë të të gjithë palëve të interesuara/prekura. Periudha për të cilën ka të bëjë Strategjia është nga viti 2017 deri në vitin 2019. Realizimi, në mënyrë strukturore dhe operative do të ndahet në 2 Plane aksionare, njëri për periudhën 2017 – 2019 dhe tjetri me radhë për periudhën 2020 – 2022.

Relacionet në zbatimin e Strategjisë janë dhënë nëpër katër perspektiva:

- Qytetarë të kënaqur;
- Sigurimi i shërbimeve;
- Zhvillimi i kapaciteteve dhe
- Menaxhimi me buxhetin.


Prioritetet strategjike (qëllimet) janë përcaktuar në bazë të analizave të thella të çdo perspektive në veçanti (strategjitë).

## HARTA STRATEGJIKE

Harta strategjike jep fotografinë mbi lidhjen shkak-pasojë të prioriteteve të Komunës së Strugës në arritjen e vizionit për KULTURË deri në vitin 2022, nëpërmjet katër perspektivave:

- Qytetarë të kënaqur;
- Sigurimi i shërbimeve;
- Zhvillimi i kapaciteteve, dhe
- Menaxhimi me buxhetin.

Në bazë të analizave gjithëpërfshirëse të secilës prej perspektivave janë përcaktuar qëllimet prioritare strategjike (strategjike) për çdo perspektivë në veçanti.



## QËLLIMET E PLANIT AKSIONAR

Qëllimi kryesor i Planit aksionar është që të zhvillojë aktivitete dhe projekte të cilat duhen të zbatohen që të sigurohet zbatim i suksesshëm i masave të identifikuara për arritjen e vlerave qëllimore të çdo treguesi, për çdo prioritet të përcaktuar në veçanti në kuadër të Strategjisë. Së bashku, Strategjia dhe Plani aksionar për kulturë do të jenë veglat kryesore të cilat do ta drejtojnë Komunën e Strugës nëpër proceset për arritjen e vizionit të komunës për zhvillimin e kulturës.

Plani aksionar i përcakton aktivitetet e Komunës në raport me kulturën të cilat duhen të ndërmerren për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2022. Gjatë përpilimit të Planit aksionar në koordinim me të gjithë palët e interesuara që morën pjesë në krijimin e tij, u konstatua se i njëjti duhet të ndahet në dy pjesë. Njëri për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2019 dhe tjetri për periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2022. E gjithë kjo, do të mundësojë zbatimin e Strategjisë në këtë periudhë kohore bazuar mbi kriteret e nevojës prioritare dhe qasjes reale të mjetet financiare për realizimin e aktiviteteve në pajtim me buxhetin e parashikuar të Komunës dhe me burimet e tjera të financimit. Ndër të tjera, një pjesë e aktiviteteve të përcaktuara do të fillojnë dhe mbarojnë brenda kornizës së parashikuar kohore, kurse një pjesë prej tyre do të fillojnë në periudhën kohore të Planit të parë aksionar, por realizimi i plotë i tyre do të mbarojë në periudhën e parashikuar për zbatimin e plotë të Strategjisë (deri në fund të vitit 2022), respektivisht me Planin e dytë aksionar. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2019 duhet të përgatitet plan aksionar për periudhën 2020 – 2022. Për përgatitjen e tij do të shfrytëzohen informacionet dhe rezultatet e Planit aksionar të përpunuar më parë (2017-2019), me mundësi që i njëjti të revidohet dhe përshtatet.

Për shkak të faktit se ky plan aksionar është projektuar mbi bazën e kapaciteteve të supozuara dhe mjeteve të disponueshme financiare, ekziston mundësia reale që një pjesë e aktiviteteve të përcaktuara, edhe pse të përfshira, të mos realizohen gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij dokumenti. Në qoftë se ekzistojnë baza dhe kushte për realizimin e tyre, ato do të barten në planin e ardhshëm aksionar 2020 – 2022.

Duke marrë parasysh faktin se në këtë dokument në Komunën e Strugës, njësia për kulturë nuk është plotësisht funksionale, dhe për të zbatuar Planin aksionar në nivel vjetor do duhet të ekipohet dhe të krijojë bashkëpunim ndërsektorial (LER, Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar dhe EU fonde, Njësia për resurse njerëzore etj).

Në masat, iniciativat dhe aktivitetet e propozuara në Planin aksionar në mënyrë plotësuese do të përpunohen projekte të cilat qartë do t'i përcaktojnë qëllimet projektuese dhe rezultatet e pritura, indikatorët, shpenzimet e nevojshme, si dhe subjektet përgjegjëse për realizimin e tyre.

